Jetëshkrim i Kryeinspektores së Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor Dibër
Znj. Brunilda Lusha

Znj. Brunilda Lusha ka lindur në 04.08.1985. Znj Lusha është diplomuar në Fakultetin e Shkencave Juridike në UFO UNIVERSITY në vitin 2010. Znj. Lusha ka përfunduar studimet e nivelit të dyte të integruara në UFO UNIVERSITY në vitin 2010.

Znj. Brunilda Lusha mban detyrën e Kryeinspektorit të Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor Dibër që nga Shkurti i 2024. Në këtë detyrë Znj. Lusha është përgjegjëse për organizimin, koordinimin, cilësinë dhe efektivitetin e veprimtarisë së ISHSH në të gjith qarkun e Dibrës. Inspektorati Shtetëror Shëndetësor ka për mision garantimin e respektimit të kërkesave ligjore në fushën e shëndetit publik.

Më parë znj. Lusha ka mbajtur detyra si Specialiste në Sektorin e Kompetencave Vendore pranë Prefektit të Qarkut Dibër, Specialiste dhe më pas Përgjegjëse e Burimeve Njerëzore në Drejtorinë Rajonale të Shëndetit Publik Dibër,Specialiste Juriste në NJVKSH Dibër, Drejtoreshë ne NJVKSH Diber.

Znj. Lusha zotëron edhe gjuhën e huaj anglisht.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
INSPEKTORATI SHTETËROR SHËNDETËSOR
DREJTORIA E FINANCAVE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI I SHËRBIMEVE TË BRENDSHME

Nr. 153/1/12 prot.

Tiranë, më 05.02.2024

URDHËR

Nr. 23, Datë 05.02.2024
PËR
EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" të ndryshuar, ligjit nr. 54/2020, datë 19.05.2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7643 datë 02.12.1992 "Për inspektimin sanitar" të ndryshuar, neni 4, paragrafi a), ligjit 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", Vendimit nr. 241, datë 27.03.2013 të Këshillit të Ministrave "Për Organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor", kreu III, pika 3, gërma b), Vendimit nr. 325 datë 31.05.2023 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvëndësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës shtetërore, Urdhrit nr. 639 datë 25.11.2022 të Ministrit të Shëndetësisë,"Për miratimin e Rregullores së Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor", Urdhrit nr. 119 datë 28.07.2022 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor", Kontratës individuale të punës:

URDHËROJ:

1. Emërimin e **Znj. Brunilda Lusha**, në pozicionin Kryeinspektor në Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor, dega rajonale Dibër.
2. Efektet financiare fillojnë në datë 07.02.2024, sipas vjetërsisë në punë në kategorinë e pagës III-3 .
3. Bazuar në Ligjin 9049, datë 10.04.2003 si dhe në Udhëzimin me nr. 927, datë 01.11.2021 znj. Lusha mbart detyrimin e deklarimit të interesave private duke plotësuar formularin para fillimit të detyrës brenda 30 ditëve kalendarike nga data e emërimit në detyrë.
4. Ngarkohet Drejtoria e Financave dhe Shërbimeve Mbështetëse në Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor Qendror si dhe Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse pranë ISHSH, dega rajonale Dibër për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEINSPEKTOR
Luneda Sufali